



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut

Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South



KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

DATE/A:	31.01.2024
REFERENC-Ë:	02-060/01-0005239-11/24
PËR/ZA/TO:	Anëtarëve të Kuvendit të Komunës
CC:	Z. Bedri Hamza - Kryetar i Komunës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Vesa Broja - Kryesues i Kuvendit të Komunës
NGA/OD/FROM:	Nazmi Jashari - Udhëheqës i Sekretarisë së Kuvendit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	RAPORT I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS 2023

Të nderuar,

Kuvendi i Komunës si organi përfaqësues dhe vendimmarrës i qeverisjes lokale, i ushtron përgjegjësitë e tij qeverisëse, duke respektuar parimet e demokracisë vendore, transparencës qeverisëse, ligjshmërisë, duke përdorur me ekonomi, efikasitet dhe efektivitet burimet njerëzore, financiare, fizike e natyrore si dhe teknologjike të komunës. Veprimtaria e Kuvendi i komunës së Mitrovicës së Jugut mbështetet në zbatimin e detyrimeve që burojnë nga Kushtetuta e Kosovës, parimet e Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe ligjet e tjera të cilat prekin nivelin lokal, Statutin e komunës si dhe rregulloret e miratuara nga vet Kuvendi i Komunës, si më poshtë:

- Ligjin për vetëqeverisjen lokale
- Ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës
- Ligjin për bashkëpunim ndërkomunal
- Ligjin për kufijtë administrativ të komunave
- Ligjin për financat e pushtetit lokal
- Ligj për zgjedhjet lokale në republikën e Kosovës
- Ligjin për sistemin e menaxhimit të performancës së komunave dhe skemën e grantit të bazuar në performancë, etj.

Raporti vjetor i punës së Kuvendit të Komunës i vitit 2023 synon të japë një panoramë analitike dhe informacionin e nevojshëm mbi aktivitetin Kuvendit dhe punën e Sekretarisë së Kuvendit në përmbushje të detyrave të këtij institucioni të rëndësishëm. Përmes këtij Raporti mundohemi t'u krijojmë informim të duhur qytetarëve lidhur me aktivitetet e të zgjedhurve të tyre lokal. Raporti shërben edhe si një mjet tjetër që do të rrisë transparencën në lidhje me aktivitetin e pushtetit lokal për periudhën e raportimit.

Në zbatim të përgjegjësiave të veta si organ i komunës, Kuvendi i Komunës ka marrë vendime të rëndësishme për periudhën janar - dhjetor 2023, si:

Kuvendi i Komunës ka miratuar Buxhetin për vitin 2023 në shumë prej 28,408,510.00 €, dhe parashikimet për vitet 2024-2025.

Raport i punës së Kuvendit të Komunës janar–dhjetor 2023

Vendim për subvencionim të familjeve raste sociale në Komunën e Mitrovicës, sipas këtij vendimi të gjithë përfituesit e familjeve nga skema e ndihmës sociale në Komunën e Mitrovicës së Jugut përkrahen financiarisht me shumë të njëhershme prej 100.00 €.

Janë zgjedhur Kryetarët dhe këshillat lokale në Komunën tonë.

Është miratuar vendimi për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2023/2024, është shpallë konkursi për ndarjen e 230 bursave për studentë, në shumë mujore prej 70 (shtatëdhjetë) €, të cilat ipen për periudhën kohore nga 1 tetori deri më 30 qershor, nga numri i përgjithshëm i ndarjes së bursave, 10 bursa do t'u ipen studentëve nga komunitetet që jetojnë në Komunën e Mitrovicës, studentët përfitues do të përzgjidhen sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me konkurs, respektivisht Rregulloren Komunale Nr. 02/2020 Për ndarjen e bursave për studentë. Kriteret për realizimin e së drejtës për bursë përcaktohen në bazë të Rregullores Komunale Nr. 02/2020 Për ndarjen e bursave për studentë.

Janë miratuar: Plani i Veprimit për Transparencë në Komunën e Mitrovicës së Jugut për vitet 2023-2027, Plani Komunal i Menaxhimit të Mbeturinave për vitet 2023-2028 DHE Plani komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin të të huajve në komunën Mitrovicës së Jugut 2023-2025.

Përmbledhje

Raporti i hartuar përmbledh të dhëna për funksionimin e Kuvendit, funksionimin e komiteteve obligative dhe funksionale, dhe komiteteve dhe trupave tjerë të Kuvendit, Planin e punës së Kuvendit të Komunës, pasqyrën e realizimit të objektivave sipas planit, si dhe vendimmarrjen. Prezantimi i aktiviteteve të Kuvendit të Komunës ka rëndësi të shumëfishtë, ngase me ligj Kuvendi i Komunës njihet organi më i lartë në strukturën organizative të Komunës dhe i ushtrojnë kompetencat vetanake dhe të deleguara në përputhje me Ligjin për vetëqeverisje lokale. Pasqyrimi i punës së Kuvendit përfshinë në mënyrë indirekte edhe shpalesje e punës së ekzekutivit, respektivisht Kryetarit të Komunës, duke ditur se ky i fundit raporton në baza të rregullta ose kur kërkohet në Kuvendin e Komunës. Andaj, ky raport ka për qëllim informimin e qytetarëve, institucioneve relevante qeveritare dhe joqeveritare, por edhe vetë komunën, lidhur me nivelin e respektimit të ligjshmërisë nga vet komuna.

Përveç funksionit legjislativ, Kuvendi gjatë periudhës raportuese ka ushtruar edhe funksionin e kontrollit dhe në përmbushje të këtij funksioni, u zhvilluan dhe u shqyrtuan raportime të Kryetarit të Komunës dhe drejtorëve të drejtorive komunale, në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës janë organizuar të dëgjime buxhetore dhe dy takime me publikun dhe dhjetë takime publike për dhjetë Draft Rregullore komunale dhe gjashtë plane. Në përmbushje të objektivave Sekretaria e Kuvendit gjatë vitit 2023 kanë punuar për mbarëvajtjen e punës në Kuvendin e Komunës. Stafi i Sekretarisë ka mbështetur dhe ndihmuar në vazhdimësi këshilltarët për plotësimin e detyrimeve të përcaktuar nga Ligji për Statusin e anëtarit të Kuvendit dhe Rregulloren e Kuvendit. Gjithashtu ka punuar në drejtim të plotësimit dhe përmirësimeve në strukturën administrative, ka punuar për koordinimin e punës në drejtim të hartimit të akteve të nxjerra nga Kuvendi dhe të hartimit të një buxheti sa më real dhe të zbatueshëm.

Gjatë kësaj periudhe, puna e Zyrës së Teknologjisë Informative (IT) ka qenë e angazhuar në vazhdimësi në mirëmbajtjen e sistemeve informative, si: rrjeti, sistemit audio, votimit elektronik, sigurimi i pajisjeve gjatë zhvillimit të aktiviteteve brenda ambienteve të Kuvendit, kompjuterët, printerët, skanerët, fax-ët, faqja e internetit, serveri, e-mail-i, akses kontrolli. Zyra për informim ka pasqyruar në faqen e internetit në kohë reale informacionin për aktivitetin tërësor të Kuvendit të Komunës. Janë mundësuar mënyra të komunikimit dhe të kontakteve efikase me mediat, duke siguruar nëpërmjet tyre një komunikim më të shpejtë dhe me një impakt të menjëhershëm.

Sa i përket menaxhimit të buxhetit të Zyrës së Kuvendit, Kryesuesja e Kuvendit dhe Sekretaria e Kuvendit, në rolin e koordinatorit të këtij procesi ka përpiluar dokumentin e Programit Buxhetor të Zyrës së Kuvendit për vitin 2024. Buxheti i Kuvendit është i ndarë dhe përfshinë të gjitha shërbimet që i nevojiten organit si një i tërë.

Kuvendi i komunës (Zyra e Kuvendit) ka pasur në buxhetin e zyrës të miratuar për vitin 2023 në shumë prej 164,000.00 €, sipas kategorive buxhetore si në vijim:

Paga dhe mëditje 152,000.00 €.

Mallra dhe shërbime 12,000.00 €

Sekretaria e Kuvendit do të vijojnë të përmbushin me kompetencë dhe cilësi, në mënyrë të paanshme dhe të pavarur, detyrat e parashikuara në Rregulloren e punës së Kuvendit.

Bazuar në nenin 40, paragrafi 2, pika d. të Ligjit Për vetëqeverisje lokale, nenin 46 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Statutit të Komunës, ky raport i paraqitet për miratim Kuvendit të Komunës. Më poshtë po bëjmë një përmbledhje të këtij raporti duke u ndalur në disa nga aspektet më të rëndësishme të veprimtarisë së Kuvendit.

Raport i punës së Kuvendit të Komunës janar–dhjetor 2023

KUVENDI I KOMUNËS

Kuvendi i Komunës në periudhën janar - dhjetor 2023 ka mbajtur gjithsej 11 mbledhje, prej tyre:

- 1) 9 - mbledhje të rregullta,
- 2) 1 - mbledhje të jashtëzakonshme, dhe
- 3) 0 - mbledhje urgjente.
- 4) 1 - mbledhje solemne.

Tabela nr. 1 - E mbledhjeve të Kuvendit të Komunës gjatë vitit 2023.

MBLEDHJET E KUVENDIT TË KOMUNËS															
Nr.	Muaji	Mbledhjet					Nr. i P i k ë v e	P. V e r b a l	P R r e g u l l o r e	P. v e n d i m	P l a n e	R a p o r t	T j e r a	V e n d i m e	Pjesëmarrja në mbledhje
		Nr. i mbledhjeve	rregullta	jashtëzakonshme	ur gj en te	solemne									
1.	Janar	1		31.01.2023		2					1	1	1	35/35	
2.	Shkurt	2	03.02.2023			11	1	1	9				7	35/35 32/35	
3.	Mars	1	22.03.2023			24	2	3	4	4	9	2	17	35/35	
4.	Prill	1	26.04.2023			10	2	2	4		1		8	34/35	
5.	Maj	1	31.05.2023			18	1	2	3	1	9		5	35/35	
6.	Qershor	1	30.06.2023			11	1		3	1	3	2	5	35/35	
7.	Korrik	1	26.07.2023			9	1		5	1	1		8	30/35	
8.	Gusht														
9.	Shtator	1	21.09.2023			6	1		2		1		3	33/35	
10.	Tetor	1	26.10.2023			12	1	1	6	1	2		37	33/35	
11.	Nëntor	1	30.11.2023			7	1	1	3			1	5	29/35	
12.	Dhjetor														
	Gjithsej	11	9	1	0	1									
						124	11	10	39	8	27	6	96		

Kuvendi si organi më i lartë i Komunës në të cilin shqyrtohen dhe miratohen aktet ligjore që janë në kompetencë të Komunës është institucioni ku zhvillohet dialogu politik konstruktiv dhe i qëndrueshëm ndërmjet të gjitha forcave politike për realizimin dhe ushtrimin të funksionit legjislativ dhe funksionit zgjedhës, kjo konsiston në treguesit e mëposhtëm:

Për periudhën raportuese Kuvendi i Komunës në mbledhjet e mbajtura ka shqyrtuar gjithsej 124 pika të rendit të punës, me ç’rast ka miratuar, 10 rregullore, 96 vendime, 8 plane, si dhe ka shqyrtuar 27 raporte.

Të gjitha mbledhjet kanë qenë të hapura për publikun duke përfshirë edhe mbledhjet e komiteteve.

Raport i punës së Kuvendit të Komunës janar–dhjetor 2023

RREGULLORET DHE VENDIMET E KUVENDIT TË KOMUNËS TË MIRATUARA GJATË VITIT 2023

Tabela nr.2 Rregulloret e miratuara

Nr.	Emërtimi i aktit	Votat			Nr. i protokollit dhe data e miratimit
		Për	Kundër	Abstenim	
1.	Rregullore Nr.01/2023 Për shfrytëzimin e përkohshëm të sipërfaqeve dhe hapësirave publike	27	1	0	02-060/01-0006466-2/23 Dt. 17.02.2023
2.	Rregullore Nr.02/2023 për Përzgjedhjen e mësimdhënësit të dalluar	27	0	1	02-060/01-0022207-2/23 dt. 22.03.2023
3.	Rregullore Nr.03/2023 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 02/2022 Për menaxhimin e mbeturinave	18	4	1	02-060/01-0022207-4/23 dt. 22.03.2023
4.	Rregullore Nr.04/2023 Për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2021 Për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane	29	1	0	02-060/01-0022207-5/23 dt. 22.03.2023
5.	Rregullore Nr. 05/2023 Për kodin e etikës së stafit menaxherial, mësimdhënësve dhe personelit tjetër arsimor	31	0	0	02-060/01- 0030580-2/23 dt. 26.04.2023
6.	Rregullore Nr. 06/2023 për Kodin e Etikës së Komunës së Mitrovicës së Jugut	31	0	0	02-060/01- 0030580-3/23 dt. 26.04.2023
7.	Rregullore Nr.07/2023 për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së veprimtarive afariste dhe veprimtarive tjera në Komunën e Mitrovicës së Jugut	26	0	0	02-060/01- 0039654-2/23 dt. 31.05.2023
8.	Rregullore Nr.08/2023 për ndarjen e subvencioneve, transfereve dhe granteve	22	0	0	02-060/01- 0039654-3/23 dt. 31.05.2023
9.	Rregullore Nr. 09/2023 Për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 07/2023 Për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së veprimtarive afariste dhe veprimtarive tjera në komunën e Mitrovicës së jugut	18	7	1	02-060/01-0076942-2/23 Dt. 26.09.2023
10.	Rregullore Nr. 10/2023 Për ndarjen e bursave për nxënësit e shkollës së mesme të lartë teknike “Arkitekt Sinani”	20	0	0	02-060/01-0084190-2/23 Dt. 30.11.2023

Vendimet E Miratuara

Tabela nr.3:Vendimet Janar 2023

Nr.	Emërtimi i aktit	Votat			Nr. i protokollit dt. 31.01.2023
		Për	Kundër	Abstenim	
1.	Për miratimin e Raportit financiar për periudhën janar-dhjetor 2022	25	0	0	02-060/01-0007095-2/23

Tabela nr.4:Vendimet Shkurt 2023

Nr.	Emërtimi i aktit	Votat			Nr. i protokollit Dt. 17.02.2023
		Për	Kundër	Abstenim	
1.	Vendim Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes të Kuvendit të Komunës të datës 27.12.2022	30	0	0	02-060/01-0006466-1/23
2.	Vendim Për mbetjen në fuqi të Vendimit për plotësim të Vendimit Nr. 02-060/01-0104125/22-7 të dt. 30.11.2022	33	0	0	02-060/01-0006466-3/23

Raport i punës së Kuvendit të Komunës janar–dhjetor 2023

	Për lejimin e pagesës së shujtave për të punësuarit e administratës komunale				
3.	Vendim Për caktimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të Kuvendit të Komunës për vitin 2023	32	0	0	02-060/01-0006466-4/23
4.	Vendim Për formimin e Komisionit për evidentimin dhe verifikimin e banesave të banimit social	33	0	0	02-060/01-0006466-8/23
5.	Vendim Për bartjen e pjesës së parë të të hyrave vetanake nga viti 2022 në buxhetin e vitit 2023	31	0	0	02-060/01-0006466-9/23
6.	Vendim Për lejimin e mjeteve financiare nga subvencionet për familjet e prekura nga vërshimet në Komunën e Mitrovicës së Jugut	31	0	0	02-060/01-0006466-10/23
7.	Vendim për Plotësim ndryshimin të vendimit për formimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale	28	0	0	02-060/01-0006466-11/23

Tabela nr.5:Vendimet Mars 2023

Nr.	Emërtimi i aktit	Votat			Nr. i protokollit dt. 22.03.2023
		Pë r	Kun dër	Abste nim	
1.	Vendim Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së 16- të rregullt të Kuvendit të Komunës dt. 03.02.2023	30	0	0	02-060/01-0022207-1.1/23
2.	Vendim për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së 17 të jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës të dt.31.01.2023	29	0	0	02-060/01-0022207-1.2/23
3.	Statuti i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare “Dr. Nexhat Çuni”	20	0	0	02-060/01-0022207-6/23
4.	Statuti i Qendrës për Punës Sociale	29	0	0	02-060/01-0022207-7/23
5.	Vendim për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2022 në buxhetin e vitit 2023	29	0	0	02-060/01-0022207-8/23
6.	Vendim për lejim të mjeteve financiare për subvencionim të NPL “Stacioni i Autobusëve” SH.A	28	0	1	02-060/01-0022207-9/23
7.	Vendim për lejim të mjeteve financiare për subvencionim të NPL “Tregu” në Komunën e Mitrovicës së Jugut	28	0	0	02-060/01-0022207-10/23
8.	Vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës “Diakonie Traninig Center”, pa procedura konkurrimi	26	0	0	02-060/01-0022207-11/23
9.	Plani i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023	29	0	0	02-060/01-0022207-12/23
10.	Plani i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2023	29	0	1	02-060/01-0022207-13/23
11.	Raport mbi vlerësimin e dëmeve si pasojë e vërshimeve në territorin e Komunës	28	0	0	02-060/01-0022207-14/23
12.	Plani vjetor i Njësisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2023	26	0	0	02-060/01-0022207-15/23
13.	Plani strategjik i Njësisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2023-2025	25	0	0	02-060/01-0022207-16/23
14.	Raporti i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022	25	0	0	02-060/01-0022207-17/23
15.	Raporti i punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2022	25	0	0	02-060/01-0022207-18/23
16.	Raporti i punës së Komitetit për Barazi Gjinore për vitin 2022	25	0	0	02-060/01-0022207-19/23
17.	Raporti i punës së Komitetit për Shërbime publike, mbrojtje dhe shpëtim për vitin 2022	25	0	0	02-060/01-0022207-20/23

Raport i punës së Kuvendit të Komunës janar–dhjetor 2023

18.	Raporti i punës së Komitetit për Planifikim Urban, Kadastër, Pronë dhe Mbrojtje të Ambientit për vitin 2022	25	0	0	02-060/01-0022207-21/23
19.	Raporti i punës së Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2022	25	0	0	02-060/01-0022207-22/23

Tabela nr.6:Vendimet PRILL 2023

Nr.	Emërtimi i aktit	Votat			Nr. i protokollit Dt 26.04.2023
		Për	Kundër	Abstënim	
	Vendim për Miratimin i procesverbalit nga mbledhja solemne e 18 kuvendit të komunës të dt. 17.02.2023	30	0	0	02-060/01-0030580-1.1/23
2.	Vendim për Miratimin i procesverbalit nga mbledhja e 19 e kuvendit të komunës të dt. 22.03.2023	30	0	0	02-060/01-0030580-1.2/23
3.	Vendim Për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë për Ministrinë e Punëve të Brendshme, pa procedurë konkurrimi	33	0	0	02-060/01- 0030580-4/23
4.	Vendim Për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, pa procedurë konkurrimi	33	0	0	02-060/01- 0030580-5/23
5.	Vendim Për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi private të personit fizik Gëzim Mikullovc	27	0	0	02-060/01- 0030580-6/23
6.	Vendim Për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi private të personit fizik Ali Emini	27	0	0	02-060/01- 0030580-7/23
7.	Vendim Për transfer dhe rialokim të mjeteve financiare	29	0	0	02-060/01- 0030580-8/23
8.	Vendim për miratimin e Raportit financiar Janar-mars 2023	29	0	0	02-060/01- 0030580-9/23

Tabela nr.7:Vendimet MAJ 2023

Nr.	Emërtimi i aktit	Votat			Nr. i protokollit dt. 31.05.2023
		Për	Kundër	Abstënim	
1.	Vendim për Miratimin i procesverbalit nga mbledhja solemne e 20 kuvendit të komunës të dt. 26.04.2023.	31	0	1	02-060/01- 0039654-1/23
2.	Vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale Arkivit Ndërkomunal në Mitrovicë, pa procedura konkurrimi	33	0	0	02-060/01- 0039654-4/23
3.	Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr.02-060/01-0022207-8/23 dt. 22.03.2023 Për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2022 në buxhetin e vitit 2023	23	0	0	02-060/01- 0039654-5/23
4.	Vendim për formimin e komisionit për të ankesave ne procesin e zgjedhjeve të Këshillave Lokale	23	0	0	02-060/01- 0039654-6/23
5.	Vendim për miratimin e Planit të Veprimit për Transparencë në Komunën e Mitrovicës së Jugut 2023/2027	27	0	0	02-060/01- 0039654-7/23

Tabela nr.8:Vendimet QERSHOR 2023

Raport i punës së Kuvendit të Komunës janar–dhjetor 2023

Nr.	Emërtimi i aktit	Votat			Nr. i protokollit dt. 30.06.2023
		Për	Kundër	Abstenim	
1.	Vendim për Miratimin i procesverbalit nga mbledhja solemne e 20 kuvendit të komunës të dt. 26.04.2023.	30	0	0	02-060/01- 0047310-1/23
2.	Vendim për miratimin e Kornizës afatmesme buxhetore 2024-2026	25	0	0	02-060/01- 0047310-2/23
3.	Vendim për Miratim të Nismës së Kryetarit të Komunës për të hyrë në bashkëpunim nderkomunal	24	0	0	02-060/01- 0047310-4/23
4.	Vendim për Miratim të planit komunal për menaxhimin e mbeturinave 2023-2028	23	0	0	02-060/01- 0047310-5/23
5.	Vendim për Miratim të planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve lidhur me raportin e auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës për vitin 2023	23	0	0	02-060/01- 0047310-8/23

Tabela nr.9:Vendimet KORRIK 2023

Nr.	Emërtimi i aktit	Votat			Nr. i protokollit dt. 26.07.2023
		Për	Kundër	Abstenim	
1.	Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e 22 e KK dt. 30.06.2023	30	0	0	02-060/01-0053918-1/23
2.	Vendim për shpalljen e konkursit publik për subjektet afariste të interesuara për t'u vendosur në "Parkun Industrial" në Frashër – Zona Ekonomike në Mitrovicë	29	0	0	02-060/01-0053918-2/23
3.	Vendim për formimin e Komisionit Vlerësues për shqyrtimin e dokumentacionit të pranuar nga bizneset afariste për t'u vendosur në Zonën e Lirë Ekonomike në Frashër, respektivisht Park Industrial ose Park Teknologjik	21	0	0	02-060/01-0053918-3/23
4.	Vendim për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme në shfrytëzim në Zonën e Lirë Ekonomike, respektivisht Park Industrial ose Park Teknologjik	21	0	0	02-060/01-0053918-4/23
5.	Vendim për subvencionimin e familjeve raste sociale	29	0	0	02-060/01-0053918-5/23
6.	Vendim për transfer dhe rialokim të mjeteve financiare	22	0	0	02-060/01-0053918-6/23
7.	Vendim për miratimin e Raportit financiar për realizimin e buxhetit komunal janar-qershor 2023	21	0	0	02-060/01-0053918-7/23
8.	Vendim për miratimin e Planit komunal për menaxhim të mbeturinave 2023-2028	21	0	0	02-060/01-0053918-8/23

Tabela nr.10:Vendimet shtator 2023

Nr.	Emërtimi i aktit	Votat			Nr. i protokollit Dt. 21.09.2023
		Për	Kundër	Abstenim	
1.	Vendim Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes të Kuvendit të Komunës të datës 26.07.2023	29	0	1	02-060/01-0068898-1/23
2.	Vendim Për miratimin e Buxhetit të Komunës së Mitrovicës së Jugut për vitin 2024 dhe parashikimi për vitet 2025-2026	26	0	0	02-060/01-0068898-1/23
3.	Vendim Për formimin e Komisionit për zgjedhjen e Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve në Institucionet edukativo arsimore dhe aftësuese Parauniversitare	27	0	0	02-060/01-0068898-1/23

Raport i punës së Kuvendit të Komunës janar–dhjetor 2023

Tabela nr.11:Vendimet tetor 2023

Nr.	Emërtimi i aktit	Votat			Nr. i protokollit dt.26.10.2023
		Për	Kundër	Abstënim	
1.	Vendim Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së rregullt të Kuvendit të Komunës të datës 26.07.2023	29	0	1	02-060/01-0076942-1/23
2.	Vendim Për shpalljen e konkursit për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2023/2024	29	0	0	02-060/01-0076942-3/23
3.	Vendim Për formimin e Komisionit të Ankesave për ndarjen e bursave	29	0	0	02-060/01-0076942-4/23
4.	Vendim Për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale Klubit të Xhudos “Trepça”, pa procedura konkurrimi	27	0	0	02-060/01-0076942-5/23
5.	Vendim Për shfuqizimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr.02-06-0044690 të dt. 29.06.2016	27	0	0	02-060/01-0076942-6/23
6.	Vendim Për miratimin e Planit komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riadhesuar dhe integrimin të huajve në komunën Mitrovicës së Jugut 2023-2025	27	0	0	02-060/01-0076942-7/23
7.	Vendim Për miratimin e Raportit financiar për realizimin e buxhetit komunal janar - shtator 2023	27	0	0	02-060/01-0076942-8/23
8.	Vendim Për transferin e shumave të ndara buxhetore	22	0	0	02-060/01-0076942-10/23
9.	Vendim Për caktimin e hapësirës publike për vendosjen e Shtatores së ish futbollistit Erion Kajtazi	25	0	0	02-060/01-0076942-11/23
10.	Vendim Për emërimin e Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit lokal të Fshatit Kçiç i Madh	24	0	0	02-060/01-0076942-9-1/23
11.	Vendim Për emërimin e Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit lokal të Fshatit Kçiç i Vogël	24	0	0	02-060/01-0076942-9.2/23
12.	Vendim Për emërimin e Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit lokal të Fshatit Koshtove	24	0	0	02-060/01-0076942-9.3/23
13.	Vendim Për emërimin e Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit lokal të Fshatrave Broboniq dhe Koprivë.	24	0	0	02-060/01-0076942-9.4/23
14.	Vendim Për emërimin e Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit lokal të Fshatrave Pirq dhe Vërnice.	24	0	0	02-060/01-0076942-9.5/23
15.	Vendim Për emërimin e Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit lokal të Fshatit Vidimriq	24	0	0	02-060/01-0076942-9.6/23
16.	Vendim Për emërimin e Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit lokal të Fshatit Suhodoll dhe Lagjes së Doktorëve	24	0	0	02-060/01-0076942-9.7/23
17.	Vendim Për emërimin e Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit lokal të Fshatrave Shupkoc, Zasellë dhe Cërnushë	24	0	0	02-060/01-0076942-9.8/23
18.	Vendim Për emërimin e Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit lokal të Këshillit lokal të Fshatrave Bajgorë, Kaqandoll,	24	0	0	02-060/01-0076942-9.9/23
19.	Vendim Për emërimin e Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit lokal të Fshatrave Vinarc i Ulët dhe Vinarc i Epërm	24	0	0	02-060/01-0076942-9.10/23
20.	Vendim Për emërimin e Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit lokal të Fshatit Gushave	24	0	0	02-060/01-0076942-9.11/23
21.	Vendim Për emërimin e Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit lokal të Fshatit Zhabar i Ulët	24	0	0	02-060/01-0076942-9.12/23
22.	Vendim Për emërimin e Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit lokal të Fshatit Zhabar i Epërm	24	0	0	02-060/01-0076942-9.13/23

Raport i punës së Kuvendit të Komunës janar–dhjetor 2023

23	Vendim Për emërimin e Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit lokal të Fshatrave Vllahi dhe Zijaqë	24	0	0	02-060/01-0076942-9.14/23
24	Vendim Për emërimin e Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit lokal të Fshatrave Mazhiq, Rashan dhe Tërstenë	24	0	0	02-060/01-0076942-9.15/23
25	Vendim Për emërimin e Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit lokal të Lagjes “2 Korriku” dhe Fshatit Lisicë	24	0	0	02-060/01-0076942-9.16/23
26	Vendim Për emërimin e Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit lokal të Lagjes Shipol dhe Fshatit Lushtë	24	0	0	02-060/01-0076942-9.17/23
27	Vendim Për emërimin e Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit lokal të Fshatrave Kutllovc dhe Tunel i Parë	24	0	0	02-060/01-0076942-9.18/23
28	Vendim Për emërimin e Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit lokal të fshatrave Vidishiq dhe Selac	24	0	0	02-060/01-0076942-9.19/23
29	Vendim Për emërimin e Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit lokal të fshatrave Trepçë dhe Stantërg	24	0	0	02-060/01-0076942-9.20/23
30	Vendim Për emërimin e Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit lokal të të Fshatit Rahovë	24	0	0	02-060/01-0076942-9.21/23
31	Vendim Për emërimin e Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit lokal të fshatrave Vaganicë e Ulët dhe Vaganicë e Epërme	24	0	0	02-060/01-0076942-9.22/23
32	Vendim Për emërimin e Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit lokal të fshatrave Frashër i Madh dhe Frashër i Vogël	24	0	0	02-060/01-0076942-9.23/23
33	Vendim Për emërimin e Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit lokal të Lagjes Qendër dhe Lagjes Adem Voca	24	0	0	02-060/01-0076942-9.24/23
34	Vendim Për emërimin e Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit lokal të Fshatit fshatrave Melenicë dhe Maxherë	24	0	0	02-060/01-0076942-9.25/23
35	Vendim Për emërimin e Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit lokal të Lagjes Ura e Gjakut	24	0	0	02-060/01-0076942-9.26/23
36	Vendim Për emërimin e Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit lokal të të Lagjes Bair	24	0	0	02-060/01-0076942-9.27/23
37	Vendim Për emërimin e Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit lokal të Lagjes Iliridë	24	0	0	02-060/01-0076942-9.28/23

Tabela nr.12:Vendimet NËNTOR 2023

Nr.	Emërtimi i aktit	Votat			Nr. i protokollit dt.30.11.2023
		Për	Kundër	Abstenim	
1.	Vendim Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së rregullt të Kuvendit të Komunës të datës 26.10.2023	27	0	1	02-060/01-0084190-1/23
2.	Vendim Për miratim të vendimit paraparak për publikimin e listës së përgjithshme të pronave të paluajtshme të Komunës si dhe listës së veçantë të pronave, të cilat planifikohen për dhënien në shfrytëzim në vitin 2024	20	0	1	02-060/01-0084190-3/23
3.	Për miratim të Vendimit për subvencionim të fermerëve dhe të bashkëfinancimit të fermerëve	22	0	0	02-060/01-0084190-4/23
4.	Vendim Për formimin e Komisionit për ndarjen e Çmimit “Lah Nimani”	23	0	0	02-060/01-0084190-5/23
5.	Vendim Për miratimin e dorëheqjes se e anëtares së Komitetit për Komunitete	24	0	0	02-060/01-0084190-6/23

Aktet e miratuara nga Kuvendi që pas vlerësimit të ligjshmërisë nga niveli qendror janë kthyer në rishqyrtim, data e kthimit nga Ministria si dhe data e rishqyrtimit dhe harmonizimit nga Kuvendi gjatë vitit 2023:

Raport i punës së Kuvendit të Komunës janar–dhjetor 2023

Tabela nr.13: aktet e kthyera në rishqyrtim,

Nr.	Emri i aktit	Data e dërgimit ne Ministri	Data e kthimit të kërkesës për rishqyrtim nga MPL në komunë	Data e rishqyrtimit dhe harmonizimit nga kuvendi i komunës
1.	Rishqyrtimi Rregullores mbi kriteret për vendosje të objekteve të përkohshme në sipërfaqe dhe hapësira publike	30.12.2022	16.01.2023	03.02.2023
2.	Rishqyrtimi i Vendimit për lejimin e pagesës së shujtave për të punësuarit e Administratës së Komunës	30.12.2022	19.01.2023	03.02.2023
3.	Rishqyrtimi i Planit komunal për menaxhim të mbeturinave 2023-2028	05.07.2023	18.07.2023	26.07.2023

Të gjitha rregulloret dhe vendimet e miratuara nga Kuvendi i Komunës janë të publikuara në ueb faqen e komunës në të dy gjuhët.

Planet e miratuara nga Kuvendi i Komunës:

Tabela nr.14 Planet e miratuara

Nr.	Emërtimi i aktit	Nr. i planit	Datë
1.	Plani i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2023	02-060/01-0022207-13/23	22.03.2023
2.	Plani i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023	02-060/01-0022207-12/23	22.03.2023
3.	Plani vjetor dhe Plani i veprimit të Njësisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2023	02-060/01-0022207-15/23	22.03.2023
4.	Plani strategjik i Njësisë së Auditimit të Brendshëm për vitet 2023-2025	02-060/01-0022207-16/23	22.03.2023
5.	Plani i Veprimit për Transparencë në Komunën e Mitrovicës së Jugut 2023-2027	02-060/01-0039654-7/23	31.05.2023
6.	Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2022	02-060/01-0047310-8/23	30.06.2023
7.	Plani Komunal i Menaxhimit të Mbeturinave 2023-2028	02-060/01-0053918-8/23	26.07.2023
8.	Plani Komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riadhesuar dhe integrimin të të huajve në Komunën Mitrovicës Jugore 2023 - 2025	02-060/01-0076942-7/23	26.10.2023

Mbetet për detyrë implementimi i tyre në praktikë dhe për të arritur sa më mirë këtë duhet bashkëpunimi i të gjithë hallkave (përfaqësues, ekzekutiv, komunitet).

Raportimi i Kryetarit në Kuvendin e Komunës

Në mesin e përgjegjësive të Kryetarit të Komunës është edhe raportimi para Kuvendit të Komunës për situatën ekonomiko-financiare si administrues i financave të komunës lidhur me shpenzimet komunale, investimet kapitale, dhe shfrytëzimin e parasë publike. Bazuar në raportimet që ka paraqitur, Kryetari i Komunës e ka përmbushur obligimin për raportim në Kuvendin e Komunës brenda vitit. Forma e raportimit ka qenë me shkrim dhe ajo verbale, të cilat janë prezantuar para anëtarëve të Kuvendit. Praktika të tilla, janë parë si mundësi e mirë e bashkëpunimit dhe llogaridhënies së ekzekutivit ndaj Kuvendit të Komunës. Kryetari i Komunës dhe ekzekutivi gjatë kësaj periudhe Kuvendit të Komunës i ka proceduar këto raporte:

1. Raporti financiar për periudhën janar-dhjetor 2022, dt. 31.01.2023
2. Raporti mbi vlerësimin e dëmeve si pasojë e vërshimeve në territorin e Komunës, dt. 22.03.2023
3. Raporti financiar Janar-mars 2023, dt. 26.04.2023
4. Raporti i punës së Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme për vitin 2022, dt. 31.05.2023
5. Raporti i punës së Drejtorisë së Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës për vitin 2022, dt. 31.05.2023
6. Raporti i punës së Drejtorisë së Mbrojtjes së Mjedisit dhe Pyjeve për vitin 2022, dt. 31.05.2023
7. Raporti i punës së Drejtorisë së Mirëqenies Sociale për vitin 2022, dt. 31.05.2023
8. Raporti i punës së Drejtorisë së Shëndetësisë për vitin 2022, dt. 31.05.2023
9. Raport i punës së Drejtorisë së Inspeksionit për vitin 2022, dt. 31.05.2023
10. Raporti i punës së Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për vitin 2022, dt. 31.05.2023
11. Raporti i korrje shirjeve për vitin 2022, dt. 31.05.2023
12. Raport i mbjelljeve vjeshtore për vitin 2022, dt. 31.05.2023
13. Raporti financiar për realizimin e buxhetit komunal janar-qershor 2023, dt. 26.07.2023
14. Raporti financiar për periudhën janar-shtator 2023, dt. 26.10.2023.

Mbledhjet e Kuvendit kanë qenë transparente, ftesat dhe materialet për mbledhjet e Kuvendit janë dërguar në përputhje me dispozitat e Ligjit për vetëqeverisje lokale, Statutit të Komunës dhe Rregullores së punës së Kuvendit. Përveç kësaj, materialet përcjellëse që kanë qenë në rend të ditës për diskutim në mbledhjet e Kuvendit iu kanë dërguar edhe MAPL-së si autoritet mbikëqyrës. Sekretaria e Kuvendit në afatet e parapara ligjore të gjitha rregulloret, vendimet dhe aktet tjera të miratuara nga Kuvendi i Komunës ia ka proceduar autoritetit mbikëqyrës, respektivisht Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, dhe në afate ligjore i ka publikuar aktet e miratuara në gjuhë zyrtare, ashtu siç e parasheh Rregullorja (e MAPL) Për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të komunave.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, të gjitha aktet e miratuara nga Kuvendi i Komunës janë publikuar në gjuhët zyrtare në faqen elektronike të Komunës. Kjo mundëson qasjen e publikut në informacionet dhe ngjarjet e komunës, si dhe krijon mundësinë për qasje më të lehtë në dokumentet zyrtare.

Sekretaria e Kuvendit ka zbatuar me korrektësi kërkesat ligjore për njoftimet publike (si në faqen zyrtare të komunës, në media vendore, me email drejtuar OJQ-ve, Drejtorëve të komunës, Zyrën e marrëdhënies me publikun në komunë) në zbatim të Ligjit Për Vetëqeverisjen lokale.

KOMITETET E PËRHERSHME

Si rregull, mbledhjet e komiteteve mbahen para mbledhjeve të Kuvendit. Duke marrë parasysh përgjegjësitë e dhëna me Ligjin për vetëqeverisje lokale, komitetet shqyrtojnë agjendën e propozuar nga Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit, ofrimi i rekomandimeve, shqyrtimi i propozim akteve dhe çështjeve të tjera të cilat parashihen për t'u trajtuar në mbledhjet e Kuvendit të Komunës. Komiteti për Politikë dhe Financa gjatë kësaj periudhe ka pasur rol të rëndësishëm në adresimin dhe trajtimin e çështjeve të ndryshme të cilat kanë qenë në interesin e përgjithshëm për Komunën. Komiteti për Politikë dhe Financa i ka trajtuar pikat e rendit të ditës para se të kalojnë në diskutim dhe miratim në Kuvendin e Komunës. Trajtim të veçantë Komiteti për Politikë dhe Financa ju ka kushtuar çështjeve të natyrës financiare, si: shqyrtimit të buxhetit, kornizës afatmesme buxhetore te komunës, si dhe çështjeve të tjera në interes të përgjithshëm si: rregulloret komunale, dhënia e pronave të paluajtshme në shfrytëzim afat shkurtër dhe afatgjatë, etj.

Komiteti për Politikë dhe Financa

Komiteti për politikë dhe financa është përgjegjës për shqyrtimin e:

- 1.1. Të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare,
- 1.2. Planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimin strategjik,
- 1.3. Kornizën vjetore buxhetore dhe afatmesme,
- 1.4. Planin vjetor të prokurimit,
- 1.5. Rregulloren vjetore për tatimet, tarifrat dhe pagesat,
- 1.6. Planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm,
- 1.7. Buxhetin vjetor dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal,
- 1.8. Për marrjen e raporteve nga Kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvend, si dhe
- 1.9. Monitorimin e bashkëpunimit, ndër komunal, me nivelin qendror dhe me jashtë.

Kuvendi mund t'i delegojë edhe përgjegjësi tjera nga fushëveprimi i tij Komitetit për Politikë dhe Financa.

Komiteti për Politikë dhe Financa për periudhën raportuese ka mbajtur gjithsej 11 mbledhje, prej të cilave 9 mbledhje të rregullta, 1 mbledhje të jashtëzakonshme dhe 1 mbledhje urgjente

Komiteti ka shqyrtuar 88 pika të rendit të punës, i janë propozuar Kuvendit të Komunës 10 Draft-Rregullore, 8 plane, ka sjellë mbi 35 konkluzione dhe 25 raporte, të cilat ia ka proceduar Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Tabela nr.15 mbledhjet e KPF-së

MBLEDHJET E KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA													
Nr.	Muaji	Nr. i mbledhjeve	Mbledhje të rregullta	Mbledhje jashtëzakonshme	Mbledhje urgjente	Nr i pika ve	P. verbal	p. rreg	P ven dim	Pl an e	Rap orte	Tje ra	Pjesëmar rja
1.	Janar	1	1			19	1		5	2	9	1	9/9
2.	Shkurt	1		1		2			2				8/9
3.	Mars	1	1			14	2	5	4	2	1	1	9/9
4.	Prill	1	1			8	1	1	5		1		8/9
5.	Maj	1	1			16	1	2	1	1	10	1	9/9
6.	Qershor	1	1			5	1		4				9/9
7.	Korrik	2	1		1	7	1	1	4		1		9/9
						1			1				8/9
8.	Gusht												
9.	Shtator	1	1			4	2		1		2		9/9
10.	Tetor	1	1			7	1		5		1		9/9
11.	Nëntor	1	1			5	1	1	3				9/9
12.	Dhjetor												
	Gjithsej	11	9	1	1	88	11	10	35	8	25		

Komiteti për Komunitete

Komiteti për Komunitete përbehet nga anëtarët e Kuvendit dhe përfaqësuesit e komuniteteve dhe është përgjegjës për:

1. Promovimin dhe afirmimin e të drejtave dhe interesave të komuniteteve dhe shqyrton çdo shkelje që bëhet në këtë drejtim dhe bën rekomandime për Kuvendin e Komunës.
2. Shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht.
3. Komiteti gjithashtu i rekomandon Kuvendit të Komunës masat që duhet të ndërmerren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për t'u avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe
4. për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda Komunës.

Komiteti për Komunitete për periudhën raportuese ka mbajtur gjithsej 11 mbledhje të rregullta, ka shqyrtuar 25 pika të rendit të ditës, janë miratuar 11 procesverbale, janë nxjerrë, 8 rekomandime për Kryetarin e Komunës dhe Kuvendin e Komunës (shih tabelën).

Tabela nr.16 mbledhjet e Komitetit për Komunitete

Mbledhjet e Komitetit për Komunitete											
Nr.	Muaji	Nr. i mbledhjeve	Mbledhje të rregullta	Nr i pikave	P. verbal	p. rreg.	rekoma ndime	plane	raporte	tjera	Pjesëmarrja në mbledhje
1.	Janar	1	25.01.2023	2	1					1	10/11
2.	Shkurt	1	27.02.2023	2	1					1	11/11
3.	Mars	1	13.03.2023	2	1					1	11/11
4.	Prill	1	28.04.2023	2	1		1				11/11
5.	Maj	1	31.05.2023	3	1		1	1			11/11
6.	Qershor	1	21.06.2023	2	1				1		09/11
7.	Korrik	1	26.07.2023	2	1				1		10/11
8.	Gusht										
9.	Shtator	1	29.09.2023	2	1					1	10/11
10.	Tetor	1	26.10.2023	3	1					2	10/11
11.	Nëntor	1	30.11.2023	2	1					1	10/11
12.	Dhjetor	1	13.12.2023	3	1			1	1		10/11
13.	Gjithsej	11		25	11		2	2	3	7	

Komitetet funksionale

Kuvendi i Komunës për kryerjen e përgjegjësi në sektor të caktuar me vendim ka themeluar Komitetin për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, Komitetin për Barazi Gjinore, Komiteti për Planifikim Urban, Kadastër, Pronë dhe Mbrojtje të Ambientit, Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Komiteti për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Komiteti për Zhvillim Ekonomik. Komitetet funksionale kanë mbajtur mbledhjet si në vijim:

Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport - ka mbajtur 0 mbledhje.

Komiteti për Barazi Gjinore - ka mbajtur 3 mbledhje.

Komiteti për Planifikim Urban, Kadastër, Pronë dhe Mbrojtje të Ambientit - ka mbajtur 1 mbledhje.

Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - ka mbajtur 2 mbledhje.

Komiteti për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim - ka mbajtur 2 mbledhje.

Komiteti për Zhvillim Ekonomik - ka mbajtur 0 mbledhje.

Komitetet konsultative

Komitetet konsultative janë trupa ndihmëse të Kuvendit të Komunës, roli i të cilave është që përmes këtyre komiteteve të garantohet që organet e komunës të jenë më transparente më efikase dhe ti japin më shumë llogari qytetarëve, si dhe të krijoj mundësinë e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje. Komitetet konsultative kanë mbajtur mbledhjet si në vijim:

- Komiteti Konsultativ për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport – 6 mbledhje
- Komiteti Konsultativ për Shëndetësi, Mirëqenie Sociale dhe Persona me Aftësi të Kufizuara – 5 mbledhje
- Komiteti Konsultativ për Shërbime Publike, Zhvillim Ekonomik, Planifikim Urban dhe Mbrojtje Të Mjedisit – 1 mbledhje.

Komisionet e Aksionarëve

Komuna si aksionare e ndërmarrjeve publike lokale, të drejtat si aksionar i ushtron përmes Komisioneve Komunale të Aksionarëve. Komisionet Komunale të Aksionarëve veprojnë në emër të Komunës dhe në përputhje me Ligjin për ndërmarrjet publike dhe Ligjin për shoqëritë tregtare. Komisionet Komunale të Aksionarëve kanë mbajtur mbledhjet si në vijim:

- Komisioni i aksionarëve të N.P “Qendra Multifunkionale” - ka mbajtur 6 mbledhje.
- Komisioni i aksionarëve të N.P “Stacioni i Autobusëve ” - ka mbajtur 4 mbledhje.
- Komisioni i aksionarëve të N.P “Tregu” - ka mbajtur 6 mbledhje.
- Komisioni i aksionarëve të K.R.M. “Uniteti” - ka mbajtur 4 mbledhje.

Në vitin 2023 Kuvendi ka synuar të forcojë më tej rolin e tij në ushtrim të funksionit kushtetues legjislativ dhe të kontrollit. Me rëndësi të veçantë dhe për t’u vënë në dukje është edhe puna e madhe që u bë nga Kuvendi për miratimin e buxhetit të Komunës për vitin 2024.

Përveç funksionit legjislativ, Kuvendi gjatë vitit 2023 ka ushtruar edhe funksionin e kontrollit politik ndaj ekzekutivit si dhe ka monitoruar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Ligjin për vetëqeverisje lokale, Ligjet dhe aktet tjera nënligjore, Statutin e Komunës, dhe vendimeve të Kuvendit të Komunës, nëpërmjet instrumenteve të kontrollit të parashikuara në Ligjin për vetëqeverisje lokale, Statut dhe me Rregulloren e punës së Kuvendit. Në ushtrim të kontrollit parlamentar u zhvilluan 14 raporte të Kryetarit të Komunës dhe drejtorëve të drejtorive, për të cilat anëtarët e Kuvendit kanë zhvilluar debat dhe kanë marrë përgjigjet për problemet e ngritura.

Objektivat e Kuvendit për vitin 2024

Për vitin 2024 Kuvendi synon të forcojë më tej rolin e tij në ushtrim të funksionit ligjor legjislativ dhe të kontrollit, të forcojë më tej rolin e tij shqyrtues, duke përfshirë shoqërinë civile dhe grupet e interesit në procesin legjislativ, të rrisë dialogun politik mes pozitës dhe opozitës, me qëllim forcimin e funksionimit të tij demokratik, të rrisë më tej transparencën për informimin e publikut me dokumentacionin e nxjerr nga Kuvendi, të forcojë më tej kapacitetet e tij administrative në përgjithësi.

Përfundime

Kuvendi i Komunës, komitetet e përhershme të kuvendit, gjatë vitit 2023 kanë mbajtur mbledhjet sipas planeve të punës.

Ftesat, materialet e mbledhjes dhe njoftimet për mbledhje janë respektuar afatet ashtu siç është përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës dhe Rregulloren e punës së Kuvendit;

Kuvendi i Komunës ka mbajtur numrin e paraparë të mbledhjeve, të parapara me nenin 43 të LVL gjatë vitit;

Ka funksionuar sistemi i teleprezencës me qëllim të monitorimit të mbledhjeve të Kuvendit të Komunës. Gjithashtu mbledhjet janë monitoruar edhe përmes pranisë fizike të monitoruesve;

Të gjitha mbledhjet kanë qenë të hapura për publikun;

Gjatë mbledhjeve në tërësi është respektuar Rregullorja e Punës së Kuvendit dhe është bërë përkthimi i vendimeve në gjuhët zyrtare;

Janë mbajtur takime publike me qytetarë, - diskutimet buxhetore, etj;

Është miratuar Buxheti i Komunës;

Kryetari i Komunës ka raportuar para Kuvendit të Komunës sipas nenit 58, pika (j);

Aktet e miratuara në Kuvendin e Komunës janë publikuar në faqet zyrtare elektronike në gjuhët zyrtare;

Pjesëmarrja e Kryetarit të Komunës dhe ekzekutivit në mbledhjet e Kuvendit ka qenë pothuajse e përhershme;

Mbetet si detyrë mjaft e rëndësishme për të ardhmen gjetja e mënyrave dhe formave për të komunikuar me publikun për çështje si diskutimi për buxhetin e komunës, këmbimit dhe dhënies në shfrytëzim të pronave, miratimi i rregulloreve etj, me qëllim pjesëmarrjen aktive në vendimmarrje të qytetarit. Del si detyrë që çdo anëtar i Kuvendit të Komunës për aktet normative të cilat do të diskutohen dhe vendosen në kuvend, të marrë opinionet dhe vërejtjet e publike në lagjen ose fshatin që ata përfaqësojnë para se të gjykohet apo shqyrtohet për të.

Punë të mbarë për vitin 2023 dhe faleminderit për kontributin e secilit prej jush!

Falënderimet gjithashtu shkojnë për:

- 1. Administratën e Komunës për punën e palodhur dhe mbështetjen që i kanë dhënë Sekretarisë së Kuvendit.*
- 2. Kabinetin e Kryetarit, Drejtoritë e komunës, zyrën e IT, Zyrën për informim dhe Zyrën për Shërbime me Qytetarë.*